



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
LAGJJA 1

Nr. prot 682/1

Kamëz, më 16.04.2026

RELACION

“Mbi emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Kamëz”

Të nderuar këshilltarë,

Duke shprehur mirënjohjen për detyrat tuaja funksionale që realizoni pranë Këshillit Bashkiak Kamëz, ju paraqesim relacionin mbi emërtimin e rrugëve në Lagjen administrative nr 1 Valias-Laknas, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave”; Vendimit nr. 226 prot., datë 27.03.2023 “Për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Bashkisë Kamëz”; si dhe referuar kërkesës me shkrim të banorëve për emërtimin e rrugës që ndodhet midis rrugës “Albanët” dhe rrugës “Amsterdam” të depozituar pranë Lagjes administrative nr.1, për emërtim rruge të lagjes së tyre.

Në bazë të verifikimeve në terren nga grupi i punës rezulton që lista emërore e banorëve korrespondon me kërkesën e parashtruar nga komuniteti i kësaj lagje dhe ju propozojmë ju në cilësinë e organit legjislativ të Bashkisë Kamëz, marrjen e tyre në shqyrtim për emërtimin e rrugës të cituar më poshtë:

- Rruga “Xhafer Shefki Bakalli”

Banorët e zonës propozojnë që rruga midis rrugës “Albanët” dhe rrugës “Amsterdam” të emërtohet rruga “Xhafer Shefki Bakalli”, pasi ky emërtimi i rrugës është një element thelbësor për jetën e përditshme, sigurinë dhe identitetin e komunitetit. Referuar verifikimeve, rruga në fjalë rezulton pa emërtim zyrtar dhe shtrihet në një pronë private, e pajisur me çertifikatë pronësie në emër të familjes “Bakalli”. Duke patur parasysh rëndësinë që ka emërtimi i rrugëve për orientimin dhe adresimin e saktë, thekojmë se rruga në fjalë aktualisht përdoret vetëm nga familja “Bakalli”, pasi ndodhet në pronë private në pronësi të kësaj familje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
LAGJJA 1

Komisioni i posaçëm ka shqyrtuar dokumentacionin e qytetarëve që kanë dërguar kërkesën me shkrim për emërtimin e rrugës dhe janë ndjekur të gjitha procedurat me qëllim realizimin e kërkesës së qytetarëve.

Për sa më lartë:

PROPOZOJMË

Miratimin e kërkesës së qytetarëve për emërtimin e rrugës “Xhafer Shefki Bakalli”, me arsyetimin se nga verifikimet në terren të Komisionit të Posaçëm të grupit të punës rezultoi që kërkesa e banorëve të rrugës “Xhafer Shefki Bakalli” që ndodhet midis rrugës “Albanët” dhe rrugës “Amsterdam” korespondon edhe gjatë takimit në terren më të njëjtën kërkesë për emërtimin e rrugës “Xhafer Shefki Bakallai” dhe kërkesa e tyre përmbush kriteret konform parashikimeve ligjore në fuqi.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin tuaj,

Komisioni i posaçëm:

- Bajram Burreli

Firma:

ADMINISTRATOR

Jeton DANI



Kërkesë

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Bashkia Komë

Me banoret e lagjes administrative nr. 1,
Loknas - Valias paragesim kërkesën tonë
për emërtimin e rrugës me emrin "Xhaxher
Shefki Bakalli".

Thëksojmë që rruga më fjale nuk ka emërtim
zyrtar dhe është pronë private me certifikatën
e familjes "Bakalli".

Rruga që bëjmë kërkesë të emërtohet është
midis rrugës "Albanet" dhe rrugës "Amsterdam".

Shpresojmë që kërkesa jonë të merret parasysh.

Bashkëngjitur do të gjëni firmat e banorëve.

DREJTUAR: KESHILLIT BASHKIAK KAMËZ.

1 NDERUAR KRYETAR,

1 NDERUAR KESHILL BASHKIAK,

NEPERMJET KESAJ KERKESË DESHIROJME TIJU PARAQESIM

PROPOZIMIN TONË SI LAGJE PER EMERTIMIN E NJË RRUGE
MIDIS RRUGËS "ALBANËT" DHE RRUGËS "AMSTERDAM".

RRUGA NË FJALË NUK KA EMËRIM ZYRTAR DHE ËSHTË
PRONE PRIVATE ME ÇERTIFIKATË E FAMILJES "BAKALLI".

DUKE PASUR PARASYSH RENDESINË E IDENTIFIKIMIT TE SAKTË
TE RRUGEVE PER KOMUNITETIN, SHERBIMET URBANE DHE ORIENTIMIN
URBAN, PROPOZJOME QE KJO RRUGË TE EMERTOHET:

"XHAFER SHEFKI BAKALLI"

DUKE VLERESUAR RENDESINE DHE KONTRIBUTIN QE KY EMERTIM MUND TË
KETË PËR KOMUNITETIN, JU LUTEMI TA MERRNI NE SHQYRTIM KËTË KËRKESË.

DUKE JU FALENDERUAR PER BASHKEPUNIMIN DHE VEMENDJEN TUAJ:

ME RESPEK;

NADIRE BAKALLI ~~NB~~ F₂ H

AMIR BAKALLI ~~AB~~

ADRIATIK BAKALLI ~~AB~~

AFERDITH BAKALLI ~~AF~~ I₂

MENTOR BAKALLI ~~MA~~ I₆

DATA:

NR. TELEFONI: 0685087498.

